



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.05.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Raporti i veprimtarisë vjetore të Institutit të Statistikave për vitin 2018.
2. Seancë pyetje-përgjigje në vijim të raportit të veprimtarisë vjetore të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2018.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj dhe Anastas Angjeli.

Mungojnë:

Arben Elezi, Senida Mesi, Ambra Barova dhe Nikolin Staka

Të ftuar:

Delina Ibrahimaj - Drejtoreshe e Përgjithshme e Institutit të Statistikave

Alban Çela – Sekretar i Përgjithshëm në Institutin e Statistikave

Elsa Dhuli- Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Prodhimit Statistikor në Institutin e Statistikave

Helda Çurma - Drejtore e Drejtorisë së Përgjithshme të Teknologjisë së Informacionit dhe Mbledhjes së të Dhënave në Institutin e Statistikave

Klajd Shuka - Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve Mbështetëse dhe Koordinimit në Institutin e Statistikave

Maldi Dema - Drejtor i Drejtorisë së Koordinimit dhe Çështjeve Ligjore në Institutin e Statistikave

Evis Shurdha - Kryetare e Komisionit të Prokurimit Publik

Brunilda Ali – Inspektore në Komisionin e Prokurimit Publik

HAPET MBLEDHJA

Arben Ahmetaj – Mirëmëngjesi!

Sot në rendin e ditës kemi dy çështje. Si çështje e parë është raportimi i veprimtarisë vjetore të Institutit të Statistikës për vitin 2018 dhe siç e kemi lënë seancën e pyetjeve-përgjigjeve, në vijim të raportit të veprimtarisë vjetore të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2018.

Të ftuar nga Instituti i Statistikës janë zonja Delina Ibrahimaj, drejtoreshë e Përgjithshme e INSTAT-it, zoti Alban Çela, sekretar i Përgjithshëm, zonja Elsa Dhuli...

(Diskutime pa mikrofon)

...e cila mungon, zonja Helda Çurma, zotin Klajd Shuka dhe zotin Klajdi Demaj.

Si pikë të dytë të rendit të ditës kemi Autoritetin e Prokurimit Publik, por do fillojmë me Institutin e Statistikës.

Ftoj drejtoreshën e INSAT-it të na bëjë raportimin për institucionin që ajo drejton. Ju lutem, më mënyrë sa më koncize, pasi raportin e kemi të gjithë para! Më pas do të kalojmë te referuesi, si dhe do të kemi pyetje, përgjigje dhe opinione sa i takon veprimtarisë.

Delina Ibrahimaj – Faleminderit!

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuar deputetë,

Është një kënaqësi e veçantë për mua sot të prezantoj para jush raportin vjetor të Institutit të Statistikave për vitin 2018, si dokumenti i parë i kësaj natyre, të cilin INSAT-i ia paraqet Kuvendit në cilësinë e institucionit të pavarur. Misioni i INSTAT-it është të prodhojë statistika asnjansë, transparente dhe të përditësuar, të cilat ndihmojnë në gjykimin e përdoruesve për proceset e zhvillimit dhe të transformimit në fushat ekonomiko-sociale të vendit. Në vizionin e tij si institucioni kryesor prodhues i statistikave zyrtare INSAT-i, si koordinator i sistemit kombëtar statistikor synon të ofrojë të dhëna të besueshme dhe të krahasueshme, duke përshtatur metodologjitë dhe duke shtuar listën e treguesve statistikorë.

Veprimtaria e INSAT-it dhe e krejt sistemit kombëtar statistikor ushtrohet në përputhje me ligjin nr. 17/2018 “Për statistikën zyrtare” dhe aktet nënligjore në zbatimin e tij. Programi i statistikave zyrtare për periudhën 2017-2021, është miratuar me vendim të Kuvendit në datën 09.02.2017, si dhe akte të tjera, të cilat rregullojnë veprimtarinë e institucioneve prodhuesve të statistikave zyrtare, mbrojtës së të dhënave personale e të tjera. Bazuar në Marrëveshjen e

Stabilizim-Asociimit, konventat dhe marrëveshjet e tjera me institucionet ndërkombëtare, institucionet prodhuese të statistikave zyrtare në vend synojmë të përafrojmë standardet statistikore të përcaktuara veçanërisht në Rregulloren 223 të Parlamentit Europian.

Vendimet e Këshillit të Ministrave për miratimin e klasifikimeve statistikore janë, gjithashtu, pjesë e kornizës ligjore, që siguron harmonizimin e emërtimeve, të klasifikimeve të produkteve, të mallrave dhe shërbimeve nga të gjitha institucionet publike, për rrjedhojë edhe harmonizimin e definicioneve të tyre nga pikëpamja statistikore në përputhje me klasifikimet statistikore ndërkombëtare.

Sa i takon prodhimit statistikor, INSTAT-i operon mbi bazën e programit 5-vjeçar të statistikave zyrtare, i cili është dokumenti bazë që parashikon prodhimin nga sistemi kombëtar statistikor i të dhënave statistikore të nevojshme, për vëzhgimin e gjendjes socio-ekonomike në Republikën e Shqipërisë, duke respektuar garancinë e zbatimit të parimeve statistikore të parashikuara në ligj, në kodin e praktikës së statistikave europiane dhe parimet themelore të Kombeve të Bashkuara.

Për vitin 2018 në programin e statistikave zyrtare 2017-2021 ishin parashikuar për t'u realizuar 149 aktivitete statistikore, 3 nga të cilat mbulohen nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 30 nga Banka e Shqipërisë dhe 116 nga INSTAT-i. Ndër aktivitetet statistikore më të rëndësishme që ka kryer INSTAT-i gjatë viti 2018 në fushën e statistikave ekonomike mund të veçohen: prodhimi i statistikave të produktit të brendshëm bruto vjetor dhe 3-mujor; publikimi i llogarisë së prodhimit dhe gjenerimit të të ardhurave sipas sektorëve institucionalë, prodhimi i treguesit të indeksit të çmimeve të konsumit dhe indeksit të harmonizuar të çmimeve të konsumit, statistikat e tregut të punës dhe pagave, treguesit 3-mujor dhe vjetor të ndërmarrjeve.

Në fushën e statistikave sociale prodhimi i treguesve të popullsisë, publikimi për të huajt dhe azilkërkuesit, statistikat e treguesve të arsimit, shëndetësisë, si dhe treguesit e krimeve. Në fushën e bujqësisë dhe të mjedisit prodhimi i treguesve të qumështit, indeksi i çmimeve të prodhimeve bujqësore, prodhimi i treguesve për mbetjet e ngurta të menaxhuara, si dhe i treguesve për sipërfaqen bujqësore të përdorur, pyjet dhe kullotat.

Në vitin 2018 INSTAT-i ka rritur numrin e publikimeve, nga 137 që ishin në vitin 2017, në 159, duke u rritur kështu me 22 publikime. Në këto publikime janë përfshirë 12 të reja, të cilat nuk janë publikuar më parë, duke veçuar publikimin e statistikave të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, publikimin e statistikave të bizneseve të huaja në Shqipëri, publikimin e treguesve rajonalë për ndërmarrjet dhe publikimin e turizmit në shifra, statistikat e regjistrimeve dhe të

diplomimeve, studimin e demografisë dhe të shëndetit në Shqipëri, statistikat e krimeve dhe të drejtësisë penale, diaspora e Shqipërisë në shifra e të tjera.

Viti 2018 mund të cilësohet se viti i konkretizimit të rekomandimeve kryesore të Bashkimit Europian dhe Eurostat-it lidhur me aplikimin e standardeve të reja të sistemit kombëtar në Republikën e Shqipërisë në përputhje me aktet themelore komunitare, të cilat rregullojnë veprimtarinë e sistemit statistikor europian, kryesisht për garantimin e pavarësisë profesionale të prodhuesve të statistikave dhe rritjen e aksesit të tyre në të dhënat administrative, të cilat disponohen nga institucionet e tjera.

I përqendruar në përmirësimin e cilësisë statistikore, INSTAT-i ka punuar në forcimin e kuadrit rregullativ dhe në hartimin e strategjive dhe të planeve për zbatimin e tyre, si dhe përmirësimin e infrastrukturës së prodhimit statistikor në të gjitha hapat e përpunimit të të dhënave. Kështu, në drejtim të rishikimit të kuadrit rregullator të sistemit kombëtar statistikor, INSTAT-i, si institucioni përgjegjës për koordinimin dhe përfaqësimin e tij, në maj të vitit 2018 hyri në fuqi ligji për statistikat zyrtare. Ky dokument bëri të mundur pozicionimin e Institutit të Statistikave në një shkallë më të lartë hierarkike dhe çoi në zgjerimin e autonomisë për administrimin dhe përdorimin e të dhënave të krijuara.

Në vitin 2018, INSTAT-i filloi zbatimin e strategjisë për zhvillimin e tij dhe për përmirësimin e imazhit si institucion, i cili synon t'u afrohet gjithnjë e më tepër interesave të kërkuarve të statistikave zyrtare. Strategjia e përgatitur nga INSTAT-i përfshin periudhën 2018-2030 dhe shoqërohet me një plan veprimi afatmesëm.

Në fushën e bashkëpunimit institucional në interes të përmirësimit të cilësisë statistikore dhe harmonizimit të përkufizimeve INSTAT-i ka nënshkruar pesë memorandume të reja mirëkuptimi me ministritë e linjës, apo me institucione të tjera publike. Në vijim të intensifikimit të marrëdhënieve me kategori të ndryshme të përdoruesve, duke i cilësuar si klientët e prodhimit statistikor dhe të interesuarit e drejtpërdrejtë për cilësinë dhe sasinë e statistikave zyrtare INSTAT-i është angazhuar në zhvillimin e sistemeve inovative informatike, për përpunimin statistikor.

Në zbatim të neneve 18, 19 dhe 20 të ligjit për statistikat zyrtare në INSTAT është krijuar bordi drejtues. Bordi ka për detyrë të përcaktojë strategjinë e zhvillimit të institucionit dhe të propozojë udhëzime dhe standarde për t'u zbatuar nga institucionet prodhuese të sistemit kombëtar statistikor. Këshilli i Statistikave, me përfaqësues nga përdoruesit kryesorë të statistikave zyrtare, ka zgjeruar numrin e anëtarëve nga 7 deri në 11. Këshilli i Statistikave performon nëpërmjet komunikimeve me drejtuesit e strukturave, që merren me prodhimin e statistikave zyrtare në mënyrë që të sigurohet cilësia e produktit të tyre.

Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar dy mbledhje të Këshillit të Statistikave, përkatësisht në prill dhe në maj të vitit 2018, ndërkohë që mbledhjet e tjera nuk kanë qenë të mundura për arsye të rishikimit të ligjit. Kuvendi është duke e marrë në konsideratë këtë fakt, priten propozimet e bëra nga Këshilli i Ministrave dhe emërimi nga Kuvendi i kandidatëve të propozuar.

Komisioni i Nomenklaturave Statistike është një organ tjetër, i cili funksionon në bazë të nenit 24 të legjislatikave zyrtare dhe shërben për garantimin dhe përputhshmërinë e klasifikimeve statistikore ndërkombëtare me ato të vendit.

Gjatë vitit 2018 ka shqyrtuar dhe propozuar pranë Këshillit të Ministrave përditësimin e listës kombëtare të profesioneve dhe klasifikimin e produkteve të konsumit sipas qëllimit. Si sfida kryesore në terma afatmesëm INSTAT-i incioi përgatitjen e censit për popullsinë e banesave. Me këtë qëllim, me mbështetjen e partnerëve ndërkombëtarë, është përgatitur projektligji i censurit të popullsisë dhe banesave dhe strategjia për evidentimin e rrugës që duhet ndjekur, vlerësimin e burimeve dhe evidentimin e pengesave të mundshme për të garantuar suksesin e këtij operacioni madhor.

I nderuar zoti kryetar,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Gjatë periudhës 4-8 qershor EUROSTAT-i kreu në Shqipëri një mision vlerësimi, i cili kishte për qëllim të vlerësonte funksionimin e sistemit kombëtar statistikor. Rekomandimet e këtij procesi janë përfshirë në planin vjetor të vitit 2019 në zbatim të programit të statistikave zyrtare 2017-2021 dhe në planin operacional të INSTAT-it për vitin 2019, i cili është një vit i rëndësishëm në kuadër të procesit të anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Në këtë drejtim, INSTAT-i, si prodhues i statistikave zyrtare ka një rol kyç në monitorimin e arritjes së objektivave të shtetit shqiptar, që do të kërkojë vëmendje dhe angazhim maksimal të institucionit në përmbushjen e këtyre detyrimeve dhe procesit thelbësor të vendit.

Në zbatim të axhendës 20-30 për objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm, INSTAT -i ka vënë në dispozicion ekspertizën e tij duke u bërë pjesë e grupit të punës ndërinstitutional teknik për arritjen e objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm që drejtohet nga Kryeministria. Ne kemi qenë vazhdimisht aktivë dhe të gatshëm në valedimin e të dhënave dhe ofrimin e ekspertizës për prodhimin e të dhënave nga ministritë e linjës, ashtu sikurse të gjitha institucionet e statistikave në të gjithë botën.

Së fundi, më lejoni të falënderoj Kuvendin e Shqipërisë, i cili vitet e fundit ka mbështetur në mënyrë domethënëse veprimtarinë e INSTAT-it dhe kërkesat e institucionit për miratimin e projektligjit bazë për ushtrimin e veprimtarisë statistikore në vend. Njëkohësisht

dëshiroj të shtoj që INSTAT-i, shpreh angazhimin për të siguruar një gamë sa më të gjerë produktesh statistikore për t'iu afruar kërkesave të kohës.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Fjalën e ka zonja Blerina.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson veprimtarinë e INSTAT-it gjatë vitit 2018 në drejtim të përmirësimit të kuadrit ligjor mbi të cilin INSTAT-i ushtron veprimtarinë e tij, pozicionimin e tij në një shkallë më të lartë hierarkie, forcimin e pavarësisë profesionale dhe mandatet për hyrjen e të dhënave administrative dhe zgjerimit të autonomisë në përdorimin e burimeve të veta, gjithashtu, përgatitjen e strategjisë së censit të popullsisë së banesave, draftfinalin e pyetësorit të censusit si edhe përgatitjen e projektligjit për censin e popullsisë dhe banesave, angazhimin në ngritjen e qendrave së trajnimit statistikor në bashkëpunim me ASPA-n për trajnimin e institucioneve publike për njohuritë statistikore dhe hartimit të planeve për rritjen e kapaciteteve profesionale të statistikienëve, forcimin e bashkëpunimit me ministrinë e linjës ose institucionet e tjera publike me botën akademike dhe median, si edhe publikimin për herë të parë të revistës shkencore, testimin dhe mënyrat e reja të mbledhjes së të dhënave dhe përdorimin gjithmonë e më shumë të të dhënave administrative, realizimin e aktiviteteve të reja statistikore për t'iu përgjigjur sa më mirë kërkesave në rritje të përdoruesve si edhe rritjen e cilësisë së produkteve statistikore, progresit të bërë në shumë fusha statistikore me fokus përputhshmërinë e sistemit kombëtar statistikor me kodin e praktikës së statistikave europiane.

Gjithashtu, Kuvendi i Shqipërisë kërkon që INASTAT-i për vitin 2019 ta fokusojë punën e tij në këto drejtime:

1. Të përfundojë pilotimin e censit të popullsisë dhe të banesave dhe të marrë të gjitha masat përgatitore, që sigurojnë kryerjen e tij me sukses në vitin e ardhshëm, si aktiviteti kryesor dhe më kompleks statistikor që zhvillohet në nivel vendi. Një plan i detajuar për kryerjen e censit t'i bashkëngjitet planit vjetor të vitit 2020 që miratohet në Kuvend.

2. Të përditësojë bazën ligjore dhe të bëjë përcaktimet e sakta në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi në çdo material të publikuar nga INSTAT-i në faqen online ku citohen ligje të shfuqizuara, si: rregullorja e brendshme e INSTAT-it, struktura organizative, strategjia e zhvillimit të INSTAT-it 2017-2030, programi kombëtar i statistikave zyrtare 2017-2021

3. Të marrë masa që pas konstituimit të mandateve të anëtarëve, Këshilli i Statistikave të përmbushë me përpikëri rolin dhe detyrat në përputhje me kërkesat e ligjit të ri nr. 17/2018 për

statistikat zyrtare dhe të japë kontribut konkret në realizimin sa më të plotë të objektivave të INSTAT-it.

4. Të bëjë publikimin e vendimeve dhe materialeve të miratuara nga Këshilli i Statistikave dhe bordi drejtues i INSTAT-it në funksion të transparencës dhe informimit duke respektuar kufizimet e legjislacionit të fushës për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale.

5. Të përgatisë strategjinë e zhvillimit të sistemit kombëtar statistikor me synim përmbushjen e detyrimeve të EUROSTAT-it për forcimin e sistemit kombëtar statistikor, si edhe zbatimin e parimeve statistikore europiane. Strategjia të shoqërohet me një plan konkret veprimi për përmbushjen e saj.

6. Të vlerësojë statistikatat e prodhuara nga ministritë dhe agjencitë e tjera statistikore dhe, duke marrë parasysh mendimin e Këshillit të Statistikave të krijojë një listë më të gjerë të statistikave zyrtare duke rritur numrin e të dhënave të transmetuara në EUROSTAT, si mënyrë për të rritur nivelin e përputhshmërisë me standardet europiane. Programi 5-vjeçar duhet të përshtatet për të mbuluar këtë listë më të gjerë të statistikave zyrtare.

7. Të forcojë rolin koordinues dhe komunikimin duke krijuar një komitet të prodhuesve të statistikave zyrtare, i cili të sigurojë zbatimin e udhëzimeve dhe standardeve për zhvillimin, prodhimin dhe shpërndarjen e statistikave në të gjithë sistemin kombëtar statistikor.

8. Të propozojë ndryshime ligjore nëse gjykon se cenohet konfidencialiteti statistikor nga legjislacioni dhe aktet e tjera nënligjore në fuqi, si ligji për arkivat dhe ligji për të drejtën e informimit për të vendosur një balancë ndërmjet ruajtjes së konfidencialitetit statistikor dhe të drejtës për informim,

9. Të vijojë përafrimin legjislacionit shqiptar për statistikatat zyrtare në përputhje me parimet e kodit të praktikës së statistikave evropiane me parimet themelore të statistikave të prodhuara nga Kombet e Bashkuara,

10. Të përmirësojë në vazhdimësi imazhin e institucionit dhe rritjen e besueshmërisë së publikut në statistikatat zyrtare, të krijojë një sistem të grupeve të përhershme të përdoruesve për konsultime periodike me synim për t'iu Afruar gjithnjë e më tepër pritshmërive të përdoruesve duke respektuar parimet statistikore dhe standardet ndërkombëtare.

11. Të forcojë bashkëpunimin me botën akademike për zhvillimin e metodave të reja statistikore e rritjes së kapaciteteve profesionale statistikore dhe me median për të rritur ndërgjegjësimin për përdorimin e statistikave zyrtare dhe edukuar audiencën për përdorimin me interpretimin sa më të mirë të informacionit statistikor.

12. Të paraqesë të njëjtit tregues, si në tabelën e indikatorëve të performancës së paraqitur, në çdo plan vjetor të punës së INSTAT-it, që të ketë mundësi krahasimi me bazë të njëjtë,

13. Të zhvillojë kapacitetet profesionale statistikore të punonjësve dhe të masë indikatorët e performancës dhe eficiencës në kryerjen e detyrave e përgjegjësi të ngarkuara, si edhe të kontribuojë në zgjerimin e njohurive statistikore të statistikienëve të agjencive të tjera statistikore dhe së fundi të intensifikojë marrëdhëniet me institucionet homologe të vendeve anëtare të BE-së dhe Kombeve të Bashkuara në mënyrë që të përfitohet me metodologjinë dhe praktikën më të mira statistikore të aplikuara, si edhe të përfitojë nga eksperiencat e institucioneve respektive.

Tani do të bëj disa pyetje.

Së pari, në lidhje me pjesën e censit të popullsisë, do të doja të dija si ka ecur puna për realizimin e aktiviteteve përgatitore të parashikuara në realizim të censurit të popullatës dhe të banesave 2020, duke pasur parasysh se edhe aktiviteti kryesor edhe më kompleks statistikor që zhvillohet në vend, është ky. Janë realizuar me ritmin e duhur apo ka vonesa dhe procese, dhe nëse po, do të doja të dija arsyet. Kjo ishte pyetja e parë.

Pyetja e dytë lidhet me faktin se INSTAT-i është thirrur si person i tretë (ishte edhe pjesë e rekomandimeve që kemi dhënë në rezolutë) në një çështje ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, e cila ka të bëjë me respektimin e konfidencialitetit të të dhënave statistikore, mbrojtjen e të dhënave personale dhe të drejtën e informimit. A konstatoni se konfidencialiteti statistikor nuk mbrohet siç duhet nga legjislacioni në fuqi? A duhen bërë propozime konkrete për përmirësime apo ndryshime ligjore?

Pyetja e tretë: cilat janë arsyet pse nuk arriti të përfundonte hartimi i strategjisë së Zhvillimit të Sistemit Kombëtar Statistikor 2018-2030, parashikuar në planin vjetor të vitit 2018, si dokumenti kryesor për t'u përgatitur?

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Fjala për zonjën Ibrahimaj.

Delina Ibrahimaj – Faleminderit për komentet dhe rekomandimet e propozuara për vitin 2019!

Këto rekomandime janë pjesërisht pjesë e planit të vitit 2019, i cili është miratuar nga Kuvendi dhe ne do të bëjmë një raportim 6-mujor pranë Kuvendit në mënyrë që të respektojmë rregullat dhe procedurat.

Në lidhje me pyetjet: pyetja e parë ishte lidhur me censin e popullsisë dhe banesave, i cili planifikohet të kryhet në vitin 2020. Viti 2019 është një vit vendimtar për kryerjen e këtij aktiviteti. Ne kemi përgatitur një plan pune për vitin 2019 dhe një plan akoma më të detajuar dhe specifik për realizimin e pilotit të censit, i cili do të shërbejë si një ushtrim për INSTAT-in, që të kuptojmë nëse përgatitjet dhe planifikimet që kemi kryer, do të na sigurojnë zhvillimin e këtij aktiviteti madhor në vitin 2020.

Pra, në muajin tetor të këtij viti, ne do të kryejmë një minicensus, në të cilin do të intervistojmë 11 mijë familje në të gjithë Shqipërinë, të shpërndara në të gjitha qarqet e republikës, ku do të testojmë pyetësoin, mënyrën e transmetimit të të dhënave, mënyrën e organizimit dhe raportimit të informacioneve apo të parregullsive dhe në fund të këtij procesi, i cili do të zgjasë 6 javë, njësoj siç është kohëzgjatja e censit të popullsisë dhe banesave në vitin 2020, ne do të reflektojmë të gjitha gjetjet gjatë këtij procesi, në mënyrë që të sigurohemi që nuk do të kemi surpriza gjatë aktivitetit të madh në vitin 2020.

Në lidhje me çështjen ku INSTAT-i është si palë e tretë ndërmjet Bankës së Shqipërisë dhe Komisionerit për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të Drejtën e Informimit, çështja është në Gjykatën e Shkallës së Parë dhe nuk ka përfunduar ende dhe ne jemi në pritje. Kjo ka lidhje me komentin e tretë që ju keni bërë në lidhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetit. Gjatë këtij viti ne do të shikojmë mundësinë që të përfshijmë në rregullat dhe rregulloret tona, rregullat europiane të GDP (*arit*), e cila është rregullorja më e re që ka lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe në përfundim të këtij procesi analize, do të gjykojmë nëse do të kemi nevojë të kemi ndryshime ligjore në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale dhe konfidencialitetit.

Për sa u përket tri aktiviteteve statistikore, të cilat nuk janë realizuar në bazë të programit të statistikave zyrtare, janë 3 vrojtme, konkretisht: anketa e të ardhurave të nivelit të jetesës; anketa e kërkim-zhvillimit dhe inovacionit dhe anketa e turizmit në familje. Këto tri anketa janë kryer si aktivitete statistikore, por nuk janë përmbushur në bazë të programit të statistikave zyrtare, sepse të dhënat e tyre nuk janë publikuar. Arsyeja pse ende nuk janë publikuar të dhënat e këtyre anketave, është sepse cilësia e të dhënave nuk ishte në standardet e duhura ndërkombëtare dhe europiane dhe kemi gjykuar që duhej edhe një raund tjetër ankete, në mënyrë që të përforcohej metodologjia dhe të dhënat të ishin në cilësinë e duhur.

Arben Ahmetaj – Te pyetja e tretë, iu rrotulluat disa herë çështjes, thatë që nuk janë publikuar, sepse nuk janë të sakta për shkak të metodologjisë, ndërkohë që është hera e tretë që ju bëni *peer review* dhe besoj se të gjitha këto çështje duhet t'i diskutoni me Institucionin e Statistikave të Bashkimit Europian (EUROSTAT) dhe t'i reflektoni në mënyrë që metodologjia...

Nuk mund të harxhoni para në vazhdimësi për anketime të përgjithshme që nuk janë pak, si censi, që është 16-17 milionë euro, të bëni nga 2-3 herë anketimet dhe të mos kemi publikime të anketës së të ardhurave në nivelin e jetesës, që është shumë i rëndësishëm pasi detyron qeverinë të marrë masa fiskale dhe të ndjekë politikat e zhvillimit ekonomik. Pra, nuk janë thjesht anketa që i bëni ju dhe i rreshtoni këtu e thoni që i bëmë. Statistikat përdoren nga përdoruesit dhe qeveria është përdoruesi kryesor, sidomos në hartimin e politikave fiskale, pastaj

Banka e Shqipërisë për harmonizimin e politikave monetare financiare, po në favor të nivelit të jetesës.

Drejtoreshë, nuk mund të tundni kokën dhe të vini këtu të thoni që shiko se

nuk ishte metodologjia e saktë. Kush do ta bëjë metodologjinë, do ta bëj unë, apo deputetët? Metodologjinë do ta bëni ju, strategjinë po ashtu. Çfarë ju ka munguar? Unë kam qenë ministër Financash dhe ju keni marrë buxhet sa herë keni kërkuar, keni marrë numra sa herë keni kërkuar dhe besoj se jeni një institucion i mirëfurnizuar. E vlerësoj shumë punën tuaj, kam punuar me ju, personalisht, në vazhdimësi, si drejtoreshë dhe si institucion, por praktikisht këto nuk janë justifikime, duhet ta pranojmë! Edhe strategjia nuk është justifikim.

Më thoni, çfarë vështirësie ka në metodologji publikimi i anketës së turizmit në familje? Keni bërë metodologjinë e gabuar. Ndoshta qeverisë do t'i duhej për diçka tjetër, ndoshta donte të fuste në sistem fiskal të gjithë ofruesit e shërbimeve; ndoshta do të akomodonte politikën fiskale në lidhje me konsumin, që lidhet ngushtësisht me turizmin, por ju nuk e keni prodhuar.

Megjithatë, ajo që dua të theksoj te përgatitja për censin, që iu referua zonja Gjylameti, është se edhe popullsia dhe qytetarët kanë nevojë për informacion. Besoj se jeni të mirëfinancuar për të bërë një fushatë modeste dhe të domosdoshme informimi për qytetarët, për t'iu shpjeguar atyre se për çfarë bëhet censi dhe sa i rëndësishëm është për vendin dhe statistikën, sa i rëndësishëm është për politikat, për vetë familjarët e të tjerë.

Besoj se keni nevojë të luani një rol më aktiv në këtë aspekt.

Ka pyetje të tjera për drejtoreshën?

Delina Ibrahimaj - Mund të bëj një koment?

Në lidhje me mosrealizimin e tri aktiviteteve, dua të përsëris se INSTAT-i prodhon statistika zyrtare dhe çelësi i prodhimit të statistikave zyrtare është cilësia me të cilën ato prodhohen. Në raport ne u jemi referuar tri anketave, me të cilat ka zbatuar metodologjitë Eurostat-ti, por treguesit që kanë prodhuar këto anketa nuk kanë qenë në cilësinë e duhur. Kjo ka ndodhur, sepse një anketë që të konsolidohet, të prodhojë tregues cilësorë duhet të ketë kaluar të paktën një raund 3-vjeçar dhe në të tria anketat nuk ishte kryer raundi 3-vjeçar.

Në lidhje me censin, dua të theksoj se censi i popullsisë dhe banesave do të shoqërohet me një strategji komunikimi, pasi komunikimi është çelësi i suksesit të aktivitetit. Kështu, do të zhvillohet një minifushatë komunikimi për pilotin e censit, ndërkohë që për censin e madh, që do të zhvillohet gjatë vitit 2020 fushata e komunikimit do të jetë e zgjeruar. Këtu do të kërkoja edhe mbështetjen e deputetëve, të cilët kanë kontakte me të gjithë popullsinë e Shqipërisë, në mënyrë që ky aktivitet kaq i rëndësishëm, jo vetëm për INSTAT-in, por për të gjithë popullin e vendit tonë, të kryhet dhe të komunikohet siç duhet.

Faleminderit!

Blerina Gjylameti – Pyetja ime kishte të bënte me arsyen pse nuk është përfunduar hartimi i strategjisë së Sistemit Kombëtar Statistikor dhe nuk mora përgjigje për pyetjen. Nëse është e mundur, do të doja një përgjigje më shteruese.

Faleminderit!

Delina Ibrahimaj - Strategjia e Sistemit Kombëtar Statistikor mbështetet nga një grant i Bankës Botërore dhe është duke u zhvilluar në këtë moment. Projekti ka filluar me vonesë për shkak të procedurave shtetërore, të cilat parashikonin ratifikimin e marrëveshjes, si dhe disa procedura të tjera. Ndërkohë, projekti ka filluar në mars dhe në fund të muajit gusht ne do të kemi në dorë strategjinë e Sistemit Kombëtar Statistikor, e cila do të integrohet me strategjinë e zhvillimit të INSTAT-it për vitet 2018-2020. Pra, strategjia e INSTAT-it do të rishikohet në bazë të strategjisë së Sistemit Kombëtar Statistikor. Brenda muajit gusht në planin e veprimit të punës do të ketë edhe një plan veprimi për zbatimin strategjisë.

Arben Ahmetaj – Unë kam një koment, drejtoreshë, lidhur me kandidaturat e ardhura nga Këshilli i Ministrave, të cilat, megjithëse kanë ardhur ditën e djeshme, pra me vonesë, kanë marrë aprovimin e komisionit dhe besoj se të shqyrtohen në seancë. Nga dokumenti i monitorimit del se Këshilli Statistikave nuk i ka kryer detyrat e tij.

Besoj se Komisioni i Ekonomisë duhet të bëjë një monitorim më të koordinuar të punës së këtij këshilli, sepse puna e tij, në bazë të ligjit, është shumë e rëndësishme për vlerësimin, për drejtimin, por edhe për strategjinë. Pra, Këshilli i Statistikës mblidhet dy herë në vit, ndërkohë që ka çështje më të rëndësishme, të cilat unë dhe ti i dimë mirë, siç është çështja e statistikave të bujqësisë, që është serioze, që duhet kapur në themel dhe nuk duhet shtyrë vit pas viti. Megjithatë, kjo nuk është puna juaj, por thjesht është një alert për komisionin.

Po, zonja Kushi.

Evis Kushi - Së pari, unë ju falënderoj për punën e vitit të kaluar, që dukshëm ka dhënë rezultate! Gjithashtu, ju falënderoj edhe për prezantimin e raportit, i cili ishte i qartë dhe i detajuar!

Unë kam një pyetje që lidhet me grupin teknik ndërinstytucional për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Sipas raportit tuaj, pra, duke iu referuar asaj që ju deklaruat, INSTAT-i është pjesë e këtij grupi, por ju thoni se nuk ka ende një rol zyrtar për prodhimin dhe monitorimin e indikatorëve të “Axshtës 2030”. A mund të na sqaroni pozicionin e institucionit, që ju drejtoni, në këtë grup? Pse nuk ka INSTAT-i një rol zyrtar për prodhimin e këtyre indikatorëve? Pra, unë kërkoj që të sqarohet roli që ka institucioni juaj në këtë grup?

Faleminderit!

Delina Ibrahimaj - Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm monitorohen nga dy grupe ndërinstytucionale: nga grupi ndërinstytucional i nivelit të lartë që është vendimmarrës, i cili është i përbërë nga të gjithë ministrat dhe nga anëtarë të tjerë, ku INSTAT-i nuk është pjesë, por merr pjesë nëpër mbledhje si vëzhgues, si dhe nga grupi teknik ndërinstytucional i punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon.)

Të dyja grupet drejtohen nga Kryeministria.

Pra, në grupin teknik ndërinstytucional të punës INSTAT-i është pjesë e grupit, por roli i INSTAT-it nuk është e përcaktuar në asnjë nga rregulloret e funksionimit të grupit. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se ne nuk kemi pasur një përfshirje aktive në hartimin e raportit vullnetar, i cili u raportua gjatë muajit korrik të vitit të kaluar pranë Kombeve të Bashkuara. Ky raport u shoqërua me një aneks statistikor, i cili u përgatit nga INSTAT-i, në bashkëpunim me të gjithë grupin ndërinstytucional të punës. Gjithashtu, ne kemi përgatitur një *dashboard*, i cili do të publikohet në datën 17, pra këtë të premte, në faqen zyrtare të INSTAT-it, ku të gjithë treguesit, që mund të prodhohen për Shqipërinë, do të monitorohen çdo ditë.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

A keni pyetje të tjera?

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zonja drejtoreshë, por edhe stafit tuaj për punën dhe angazhimin në veprimtarinë e institucionit tuaj për vitin 2018!

Unë kam një pyetje: cilat janë arsyet që numri i publikimeve të reja është rritur vetëm 4,3%, krahasuar me parashikimin prej 17% në tabelën e indikatorëve të performancës për planin vjetor të punës për vitin 2018?

Numri i indikatorëve nga Shqipëria në botimet e Eurostat it paraqitet me një rritje prej 56% në raportin e vitit 2018. Ndërkohë, referuar planit vjetor për vitin 2018, ky tregues paraqitet 77% në vitin 2017, dhe 85% ka qenë synimi në vitin 2018, gjë që tregon se keni një ulje. Cilat janë arsyet dhe pse është realizuar nën nivelin e parashikuar të vitit 2018, njëkohësisht edhe nën nivelin e treguesit të vitit 2017?

Faleminderit!

Delina Ibrahimaj – Në lidhje me numrin e publikimeve të reja, janë 3 publikime, të cilat nuk janë realizuar, gjë që ka ndikuar në mosarritjen e objektivave. Në lidhje me treguesit që ne transmetojmë në Eurostat për vitin 2018 ato janë rritur me 56%. Pra, janë konform parashikimeve tona dhe janë pikërisht këta tregues që nuk janë transmetuar nga tri vërtetimet që përmenda, të cilat nuk na kanë lejuar që të arrijmë objektivat. Pra, edhe publikimet edhe transmetimi i të dhënave në Eurostat kanë të njëjtën arsye për mosrealizimin.

Ndërkohë që treguesit e performancës, që janë paraqitur në faqen 24 të raportit, janë tregues, të cilët janë vendosur gjatë vitit 2018, pasi më parë institucioni nuk ka pasur tregues performance. Kjo është një arsye pse të dhënat për vitet 2016-2017 nuk janë reflektuar ende, por këta tregues do t'i reflektohen në vijim në të gjitha raportet që ne do ti dorëzojmë Kuvendit.

Arben Ahmetaj – Po, zoti Bushati

Ervin Bushati – Faleminderit!

E falënderoj drejtoreshën për prezantimin!

Në fakt, ne kemi miratuar një sërë nismash dhe një ligj tërësisht të ri për statistikat zyrtare për të rritur besueshmërinë. Dua të di nëse ka një strategji të shpejtë dhe afatgjatë për të rritur besueshmërinë, sepse sot jemi maxhorancë dhe nesër mund të jemi minorancë dhe duhet të përfundojë njëherë e mirë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është e nesërmja e largët. Pra duhet të përfundojë loja politike...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më lini ta mbaroj. Çfarë mund të bëjë institucioni juaj për të rritur besueshmërinë? Pra masat që do të merren në popullatë dhe që do të shtrihen më gjerë, që të dalim një herë e mirë nga rrethi vicioz i diskutimit, shifrat janë të INSTAT-it nuk janë tonat. Kjo është pyetja e parë.

Pyetja e dytë ka të bëjë me demografinë. Ne kemi një sfidë demografike dhe këtë duhet ta pranojmë, pra kemi ulje të lindjeve dhe largim të popullatës. Kjo në efektet neto mund të ndikojë në ekonomi. Ndërkohë që ekonomia vazhdon të rritet dhe GDP-ja *per capita* në PPP-në e fuqisë blerëse mund të vazhdojë të rritet, por do të jetë presioni i rritjes ekonomike. Si e mendoni këtë në të ardhmen?

Pyetja e tretë, ka presione të brendshme dhe të jashtme në klimën ekonomike shqiptare, pra kemi një ekonomi europiane që po rritet, e cila ka edhe sfidat e veta. Gjithashtu, kemi edhe ngjarje politike në Shqipëri, të cilat mund të dëmtojnë rritjen ekonomike, siç janë: anulimi i prenotimeve turistike, ulja e konsumit dhe kur ka turbulenca politike. Pra a ka një faturre financiare sa herë që ka protesta dhe klimë pasigurie, të cilat dëmtojnë ekonominë shqiptare?

Nëse e keni parashikuar, sa është fatura financiare e një muaji proteste, e një proteste të vetme apo e një koncepti të tillë? Këto janë tri pyetjet e mia.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Drejtoreshë, përgjigjuni në bazë të kuadrit ligjor që ju autorizon të drejtoni institucionin tuaj.

Faleminderit!

Delina Ibrahimaj – Faleminderit!

Në lidhje me reputacionin e institucionit, INSTAT-i ka si objektiv rritjen e reputacionit brenda strategjisë së zhvillimit të vet. Ne që nga viti i kaluar, me miratimin e ligjit për kalimin e institucionit si institucion i pavarur, kemi bërë një hap të madh drejt perceptimit të popullatës për independencën e institucionit, pasi me kohë ka pasur një pavarësi institucionale në prodhimin e treguesve statistikorë.

Ne në planin e punës për zbatimin e strategjisë kemi parashikuar disa hapa konkretë për rritjen e reputacionit të institucionit, megjithatë, INSTAT-i është një ndër institucionet më të besuara të shtetit shqiptar. Ne prodhojmë të dhëna për bazën e metodologjive europiane dhe të gjitha metodologjitë e prodhimit të të dhënave janë të publikuara në faqen tonë të web-it, i cili është një standard garancie për qëndrueshmërinë dhe cilësinë e të dhënave që ne prodhojmë.

Dua t'i rikthehem edhe një herë tri aktiviteteve që nuk i kemi realizuar. Një nga arsyet e mosrealizimit të këtyre aktiviteteve është se të dhënat që të jenë cilësore duhet të jenë të qëndrueshme dhe kuptimplota, në mënyrë që të përdoren edhe nga politikbërësit në të ardhmen.

Në lidhje me treguesit demografikë, INSTAT-i është matës i dukurive sociale dhe ekonomike, pra ne prodhojmë treguesit për popullsinë në bazë vjetore. Një e dhënë e saktë mbi demografinë do të dalë nga censusi i popullsisë dhe i banesave në vitin 2020, megjithatë në çdo muaj shkurt të vitit ne nxjerrim numrin e popullsisë nga 1 janari i çdo viti.

Është e vërtetë që gjatë viteve të fundit ka pasur një migracion dhe ulje të normave të fertilitetit, pra ka pasur rënie të lindjeve dhe ulje të të vdekurve, megjithatë, kjo dukuri është brenda parashikimeve që ka bërë INSTAT-i për popullsinë. Pra, rezultatet e demografisë nuk janë surprizë për institutin e statistikave. Në gjykimin tonë, gjatë 30 vjetëve të ardhshëm do të vazhdojë të ketë të njëjtin trend demografik, pra të ketë të njëjtin ritëm emigracioni dhe imigracioni dhe do të kemi të njëjtin ritëm të normave të fertilitetit.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, 1,37. Rënia e lindshmërisë është një problem, i cili është në të gjithë botën, ndërkohë që duhet të adresohet nga institucionet e duhura.

INSTAT- i nuk mat faturat financiare apo politike të protestave, prandaj për pyetjen e tretë nuk kam komente.

Arben Ahmetaj – Faleminderit, drejtoreshë!

Zoti Bushati, besoj se vitet e fundit jemi munduar dhe ia kemi dalë që ta mbajmë të pavarur INSTAT-in. Unë e kuptoj pyetjen dhe shqetësimin tuaj që protestat kanë dëmtuar ekonominë dhe imazhin e vendit, por INSTAT-in do ta mbajmë jashtë këtij debati edhe për ato arsye që ju iu referuat, sepse ka të bëjë me imazhin, reputacionin, dhe pavarësinë e këtij institucioni.

Ndërkohë, për sa i përket pyetjes suaj për lindjet dhe popullsinë, është një situatë, e cila për herë të parë ka ardhur në tryezën e politikbërësve si fenomen demografik, por edhe si fenomen ekonomik, sepse në finale rrudhja e popullsisë korodon bazën e konsumit dhe automatikisht do të prekë të gjithë parametrat ekonomikë. Kjo situatë u takon politikbërësve për të marrë vendimet e duhura për parashikimet e të nesërmes apo edhe në parandalimin e të nesërmes potenciale.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, ju lutem.

Delina Ibrahimaj – Për vitin 2018, të ardhurat kanë ardhur në rritje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë mund ta kontrolloj.

Arben Ahmetaj – Mund ta nisni me shkrim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Unë ju kërkoj të merrni një kontakt me sekretarin e komisionit, në mënyrë që stafi juaj të dërgojë raportet sapo të dalin. Ju sigurisht i nxirrni në web-in tuaj, por për një komunikim më të shpejtë, dikush nga ju t'i dërgojë sapo të dalin.

Po.

Alban Çela – Ne kemi një listë, por do t'ju shtojmë edhe ju për dërgimin e të dhënave sapo të dalin...

Arben Ahmetaj - Si të mos jetë Kuvendi përdorues?

Ju lutem! T'jua bëjm me shkrim që të na shtoni te lista e përdoruesve?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Edhe një herë që fole na shkatërrove fare!

Faleminderit!

Ka ndonjë pyetje tjetër? Nuk ka.

Ervin Bushati - Faleminderit!

Mendoj se edhe ju keni bërë një punë shumë të mirë për të rritur besueshmërinë dhe pavarësinë e këtij institucioni. Në të ardhmen duhet të ketë një strategji të detajuar, duke filluar, pse jo të njëjtin aksion si Banka e Shqipërisë, në pjesët më fillestare të edukimit, njohjen e parametrave kryesorë të ekonomisë dhe duke rritur besueshmërinë në të njëjtën mënyrë. Pra, të kemi strategji në disa nivele. Në fund të punës sonë të mos jetë më ky diskutim: “INSTAT-i juaj dhe ne kemi shifrat tona”. Të mos vazhdojë biseda politike pa sens: “Është rritja ekonomike, por pse nuk e ndiejmë ne?” Të paktën, kur flitet për ekonominë të hiqet pjesa romantike nga diskutimi politik, intelektual i bisedës.

Ndërkohë që themi se po rritet ekonomia dhe të ardhurat për frymë, nëse janë 12 mijë dollarë në fuqi blerëse, janë të rëndësishëm, të mos vazhdohet me këtë se ka rritje 4 % në ekonomi, marrin më shumë njerëzit, por vazhdon diskutimi: “Nuk e ndiejmë”. Kjo duhet të dalën nga diskutimi dhe ju mund të jepni një ndihmë të madhe. Kjo është e para.

E dyta, dua të futet në diskutim, pse jo edhe nga ana juaj, sot në botë diskutohet për fuqinë blerëse, për PPB-në në terma PPP-je, për ata që na ndjekin është *Purchasing Power Parity*, nuk është PPP-ja e koncesioneve, fuqia e blerësve, sa kanë qytetarët dhe Shqipëria nuk është në vendet e fundit, as në rajon, as në Europë. Për sa merr, me çmimet që ka? A janë qiratë më të ulëta? A janë çmimet në treg më të ulëta? Për ato që marrin, kanë fuqi blerëse, ndoshta dhe si shumë vende të tjera në Europë. Kësaj duhet t’i jepet një përparësi dhe të nxirret në evidencë edhe se si shkon në vite.

Mendoj se për sa i përket demografisë, nëse indeksi i fertilitetit, për të zëvendësuar popullatën është 2,1, pra, çdo çift duhet të lindë 2,1 fëmijë që të zëvendësohet popullata, 1,37 nëse është e saktë, por më duket shumë e ulët, është një nga më të ulëtat ndoshta në Europë. Dyshoj të jetë 1,37. Mos është 1,73? Megjithatë, edhe nga ana juaj duhet të vihet një koncept apo një strategji që të fillohet dhe të punohet në këtë drejtim. Pse jo të paraqiten edhe masat, çfarë bëhet në vendet e tjera dhe të fillojë të diskutohet kjo, sepse 1,37 është shumë e ulët dhe nuk besoj se është e vërtetë.

Arben Ahmetaj - Pikërisht bëtë atë që nuk deshët ta bënit dhe alertuat që nuk duhet bërë, vutë në dyshim statistikën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ervin, duke bërë titullin në komision, nuk shtohet popullsia. Shtimi i popullsisë ka një sërë parametrash që duhen adresuar, përmirësuar, parametra ekonomike...

Ti bërtit sa të duash, ajo 1,37 do të mbetet nëse nuk përmirësojmë parametrat e tjera. Nuk të kemi ftuar si kontribuues kryesor këtu. Je anëtar i parlamentit.

Drejtoreshë, unë dua të theksoj disa elemente të punës së INSTAT-it. Do ta filloj nga një element që tingëllon si i parëndësishëm, por në fakt ka të bëjë edhe me atë që, me të drejtë, iu referua zoti Bushati.

Debati për rritjen ekonomike, por edhe të të gjithë komponentëve, duke përfshirë edhe konsumin, është shumë i rëndësishëm të detajohet dhe të fragmentohet. Ju keni statistika shumë të mira për punësimin, të cilat në çdo debat politik, profesional, akademik apo mund t'i referohet çdo lloj kategorie, por besoj se ka nevojë për një punë më të detajuar nga ana juaj me medien. Kam pasur fatin ta ndjek disa herë punën e Eurostat-it, nuk mjaftohet me publikimin. Ju e dini, kur bëni *peer review*, merrni shembuj edhe nga puna e rajonit, e vendeve anëtare, por edhe vetë

Eurostat-it. Nuk mjaftohet me publikimin. Ka nevojë që statistikën t'u shpjegohen jo vetëm politikbërësve. Politikbërësve patjetër, sepse shumë nga ne nuk arrijnë t'i kuptojnë statistikën, ka raste që aq shumë i injorojmë statistikën, ose nuk i kuptojmë dhe vijmë dhe hedhim politika shumë populiste, të cilat shkojnë në kundërshtim me trendin. E kam parë, e kam prekur, e kam vuajtur. E ka parë vendi, e ka prekur, e ka vuajtur. Kjo do të thotë se ju keni nevojë t'u shpjegoni politikbërësve statistikën që nxirrni. (Kjo është shumë e domosdoshme), përdoruesve, siç ju referuat ju. Faleminderit që do të na shtoni edhe ne! Do t'ju bëjmë shkresën me shkrim.

E dyta, keni nevojë për një komunikim më të afërt me medien për të shpjeguar statistikën. Shembulli që solli zoti Bushati është shumë i drejtë, që ekonomia rritet 4,1 % ndërkohë ju keni nxjerrë edhe anketën e shpenzimeve të familjes, që kanë filluar në kuptimin më pozitiv të fjalës të përmbysen. Asnjë nuk e kupton. Nuk mjafton që ta kuptoj unë. Nuk mjafton ta kuptoj komisioni, por duhet të ndahet edhe me publikun, në mënyrë profesionale, të pavarur dhe pa ngjyrim. Aty ku gjërat shkojnë në trendin e gabuar, komentit do të thotë se këto janë përkeqësuar, aty ku shkojnë. Si në rastin konkret të anketa të shpenzimit të familjeve, që nuk e kupton njeri. Ju i referoheni 20%-shit të të ardhurave të ulëta që kanë rritur konsumin e të tjera, por mënyrën sesi e shprehni, kjo është detyra juaj. Besoj se ma kuptuat idenë, se ka nevojë që brenda strategjisë suaj të ketë edhe një strategji komunikimi, sepse kjo e fundit sjell edhe instrumentin e alertimit për politikbërësit, por edhe për popullatën. Besoj se përgatitja për censin është shumë e rëndësishme. Censi në vitin 2020 do të na japë një ide shumë të qartë se ku jemi me popullsinë, me banesat. Janë të dhëna që do të na ndihmojnë edhe për të planifikuar politikën e së ardhmes. Kjo nuk diskutohet.

E treta, që besoj se do ta korrigjoni, ato 3 anketa që nuk i keni bërë, duhet t'i bëni, sepse duhen shumë. Nuk është se thjesht keni inventarin e anketave. Ajo që ka të bëjë me nivelin e jetesës është shumë e rëndësishme, ajo që ka të bëjë me bujqësinë është shumë e

rëndësishme. Ju e kuptoni shumë mirë që statistikën në bujqësi ende nuk janë në atë nivel që mund të na japin një reflektim të drejtë për rritjen ekonomike. Unë dhe e ti e kemi vizituar zyrtarisht se si statistikën në vitet 2006-2007 në bujqësi janë shtrembëruar dhe e ka vuajtur statistika e bujqësisë edhe reflektimin në prodhimin e brendshëm nga viti në vit. I bie që kjo histori një ditë duhet të mbyllet në favor të transparencës së plotë dhe pastaj kuptohet që politikëbërësit në varësi të tyre do të hartojnë politikat.

E treta, kemi votuar Këshillin e Statistikave. Për çfarë e kemi votuar? Është një instrument thjesht për t'u dhënë 8 vetave nga një titull tjetër apo nga një honorar tjetër? Jo. Këshilli i Statistikave është pavarësia e pavarësisë dhe praktikisht është vlerësimi i pavarësisë, vlerësimi i profesionalizmit, pse jo, edhe orientimi i pavarësisë dhe orientimi i profesionalizmit.

Janë të gjithë përdorues që kanë ardhur në këshill, që mund të vlerësojnë punën tuaj, mund ta orientojnë punën tuaj, mund të mbajnë qëndrime të rëndësishme, por edhe mund t'ju ndihmojnë.

Ndërkohë, është momenti që, nëse ka ndonjë mungesë financimi për censin, të filloni të na alertoni menjëherë tani, që viti 2020 të mos ketë problematika financiare për ju.

Qysh tani duhet të bëni letër këtu, në KM, gjithashtu, që nëse ka një gap në financim nga donacionet, edhe pjesa e Kryeministrit, pjesa e Ministrit të Financave dhe jona të bëjnë punën e duhur për të tërhequr financim, qoftë në formën e grantit, qoftë në alokim nga Kuvendi për buxhetin tuaj në funksion të censit.

Faleminderit!

Punë të mbarë!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësi i Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 14.05.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Arben Ahmetaj – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Seancë pyetje-përgjigje në vijim të raportit të veprimtarisë vjetore të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2018.

Marrin pjesë:

Arben Ahmetaj, Roland Xhelilaj, Xhevit Bushaj, Reme Lala, Blerina Gjylameti, Antoneta Dhima, Evis Kushi, Ervin Bushati, Vullnet Sinaj dhe Anastas Angjeli.

Mungojnë:

Arben Elezi, Senida Mesi, Ambra Barova dhe Nikolin Staka

Të ftuar:

Evis Shurdha - Kryetare e Komisionit të Prokurimit Publik

Brunilda Ali – Inspektore në Komisionin e Prokurimit Publik

Arben Ahmetaj – Pika e dyta është seanca e pyetje-përgjigjeve në vijim të raportit të veprimtarisë vjetore të Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2018, shoqëruar edhe nga rezoluta.

Urdhëroni, zonja Evis Shurdha, sa më koncize përgjigjet, ju lutem!

Evis Shurdha - Faleminderit!

Kuvendi i Shqipërisë vlerëson veprimtarinë e KPP-së për vitin 2018 në drejtim të monitorimit me rigorozitet për respektimin detyrimit ligjor nga autoritetet kontraktuese për vënien në dispozicion të informacionit përkatës të nevojshëm për të realizuar në mënyrë të plotë

shqyrtimin administrativ dhe t'i propozojë APP-së marrjen e masave administrative sipas ligjit në rastet e mosrespektimit të këtij detyrimi nga ana e autoriteteve kontraktuese;

miratimin e rregullave të hollësishme të procedurës, siç është edhe rregullorja e brendshme për mënyrën e organizimit dhe funksionimit të KPP-së, të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në efektivitetin dhe performancën e institucionit;

dhënien e asistencës së nevojshme ligjore në lidhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi që prekin procedurat e prokurimit, koncesionet, PPP-të, ankandet dhe lejet minerare;

bashkëpunimin e vazhdueshëm me institucionet partnere ndërkombëtare, kryesisht i orientuar në organizmin e disa trajnimeve dhe aktiviteteve të shkëmbimit të eksperiencave me synim rritjen e kapaciteteve profesionale të punonjësve të KPP-së në lidhje me zhvillimet më të reja në mekanizmat e rishikimit administrativ të prokurimit publik me vendet e BE-së dhe në rajon, si dhe mënyrat dhe metodat më të mira të menaxhimit të institucioneve homologe;

rritjen e të ardhurave të derdhura në buxhetin e shtetit nga tarifat e ankimimit të operatorëve ekonomikë për të cilët në fund të procesit administrativ është vendosur mospranimi i ankesës së tyre;

së fundi, hartimin e rekomandimeve të qarta mbi bazën e analizave të bëra për të gjitha institucionet, të cilat përfshihen në procesin e prokurimit publik, si dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera të fushës.

Ndërkohë, Kuvendi këshillon që për vitin 2019 KPP-ja të përmirësojë punën në këto drejtime:

1. të publikohet në faqen ueb të institucionit, në fund të çdo viti, lista e procedurave ankimuese, të cilat janë ose u ka përfunduar procesi gjyqësor, fondet limite të këtyre procedurave, objekt ankimimi, si dhe nëse ndonjë nga këto procedura është depozituar në gjykatë për arsye të mosshqyrtimit të ankesës brenda afateve të përcaktuara në ligj;

2. të rritet bashkëpunimi me Gjykatën Administrative për sa i takon trajnimit të punonjësve të të dy institucioneve, me qëllim aftësimin e tyre për të trajtuar çështje komplekse të prokurimit publik dhe për t'u përballur me numrin në rritje të ankimimeve në zbatim të rekomandimeve të lëna progresraport;

3. të forcohen kapacitetet administrative të KPP-së duke e bërë totalisht funksionale strukturën e miratuar nga Kuvendi deri në fund të vitit 2019;

4. të merren hapa konkretë në drejtim të standardizimit dhe kategorizimit të ankimeve në zbatim të rekomandimeve të lëna në progresraport;

5. të bëhet transparente në vendimet e publikuara nga KPP-ja edhe procesi i votimit të anëtarëve të komisionit, si dhe rastet e përjashtimit gjatë procesit të shqyrtimit ankimor të ndonjërit prej anëtarëve;

6. të plotësohet regjistri elektronik i ankesave me elemente shtesë të nevojshëm, siç është dokumentacioni shoqërues i ankesës së operatorit ekonomik dhe vendimi i Gjykatës nëse çështja ka kaluar për gjykim.

Ndërkohë, kam disa pyetje. Në bazë të raportit që ju kemi sjellë, kemi parë që ka rreth 722 çështje të cilat janë trajtuar jashtë afateve. Pra, nga totali i çështjeve të shqyrtuara, 722 janë jashtë afatit ligjor, pra 15 ditëve.

Cilat janë arsyet e trajtimit jashtë afatit?

Kam sugjerimin që të kemi edhe një evidencë që për sa ditë jashtë afatit janë trajtuar këto çështje. Si ka qenë vendimmarrja rast pas rasti?

Për pyetjen e dytë, në zbatim të ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, as në faqen e institucionit, as në raportin vjetor të paraqitur nuk bëhet e ditur nëse vendimet janë marrë në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, ku

pika 1 ka të bëjë me komisionin e prokurimit publik shqyrton ankesat e paraqitura prej tij kur në mbledhje janë të pranishëm, të paktën, 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari apo nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave komisioni vendos me shumicë votash.

Pyetja ka të bëjë me faktin pse përfshihet termi “njëzëri” në depozitimin e vendimit kur komisioni është organ kolegjal dhe merr vendim me shumicë votash?

Në strukturën e vendimmarrjes së organeve kolegjiale përfshirë këtu edhe Gjykatën Kushtetuese vendimmarrja pasqyrohet në firmosjen pro dhe kundër të të gjithë anëtarëve pjesëmarrës.

Pyetja e tretë ka të bëjë me vendimmarrjen të KPP-së, për kërkesë-paditë e depozituara në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë. Janë 85 kërkesë-padi kundër 843 vendimeve në total të marra nga komisioni gjatë vitit 2018. Gjykata ka pranuar kërkesë-padi për 11 vendime dhe 31 janë ende në vijim, ajo që është pyetje, por ndërkohë edhe sugjerim, është: përse mungon një pjesë e mirë e informacionit në raport? Sugjerimi është që t’i kemi të listuara në një tabelë të gjitha objektet e prokurimeve për secilin vendim të ankimuar në gjykatë, për autoritetin kontraktor, i cili ka shpallur procedurën e prokurimit, fondin limit të procedurës së prokurimit, si dhe objektin e kundërshtimit të vendimmarrjes së KPP-së.

Në mënyrë të tillë, informacioni që mund të na sillni, e që duhet të jetë edhe pjesë e raportit, na sqaron në lidhje me të gjitha arsyet se përse janë pranuar vendimet apo pse janë refuzuar vendimet në rastin e gjykatës.

Faleminderit!

Evis Shurdha – Të nderuar zotërinj deputetë,

Ju faleminderit për pyetjet!

Të fillojmë me pyetjen e parë, që lidhet me çështjen e afateve, çështjen e respektimit të afateve.

Si parantezë, dua t'ju kujtoj se viti 2018 ka qenë një vit specifik. E para, sepse Komisioni i Prokurimit Publik është konstituuar gjatë vitit 2018. Në qershor të vitit 2018, anëtarët e komisionit të vjetër kanë përfunduar mandatin e tyre dhe vetëm në korrik është filluar puna me komisionin e ri. Kjo do të thotë se për një muaj rresht, Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka funksionuar normalisht në shqyrtimin ankesave. Kjo është njëra nga arsyet.

Arsyeja e dytë ka të bëjë me strukturën, e cila pavarësisht se gjatë vitit 2018 u miratua në Kuvend, efektet e saj buxhetore nisën më 1 janar të vitit 2019. Pra, do të thotë se në nuk arritëm ta mbyllim dot procesin e ristrukturimit, e njëherazi edhe të hapim rekrutimet e reja, për t'u plotësuar me staf.

Aktualisht, nga 36 persona të punësuar, ne jemi vetëm 24 të punësuar. E kemi mbyllur procesin e ristrukturimit, dhe ndërkohë kemi hapur procedurat për rekrutimin. Sipas procedurave ligjore për shërbimin civil, shpresoj se shumë shpejt do të pajisemi me stafin e duhur.

Kjo është pjesa e parë, që do të thotë se viti nuk ka qenë i rregullt në funksionimin e KPP-së. Nga ana tjetër, me hyrjen në fuqi të mandatit të anëtarëve të rinj, harmonizimin e tyre me punën e me veprimtarinë normale të KPP-së, ky tregues i realizimit në afat të shqyrtimit të ankesave, është përmirësuar në tremujorin e fundit. Ky tregues ka qenë 73, 62 % e ankesave të shqyrtuara brenda afatit. Ky lloj trendi është tentuar të mbahet edhe përgjatë vitit 2019, gjë që do të jetë pjesë e raportit të vitit 2019.

Këto janë arsyet specifike të vitit 2018.

Për sa i përket pyetjes së dytë, që lidhet me të drejtën e informimit, për çështjen e dispozitivit të vendimit. Është e vërtetë se ne funksionojmë në bazë të ligjit “Për organet kolegjiale”. Kur shumica e anëtarëve ka një mendim të ndryshëm nga pjesa tjetër, atëherë ne bëjmë pjesë të vendimit dispozitivin me shumicë. Në qoftë se të gjithë të pranishmit, ashtu sikundër parashikon ligji “Për organet kolegjiale”, të gjithë të pranishmit kanë të njëjtin mendim, pra të njëjtin vendim, sepse mendimi i shumicës konsiderohet vendim, atëherë nuk është më me shumicë, por është njëzëri.

Ky është rast i ndryshëm shumice nga vendimet njëzëri, Është e vërtetë që ne nuk kemi një statistikë të saktë të vendimeve që janë marrë me shumicë, nga ato njëzëri, por besoj se duke

marrë në konsideratë rekomandimin që ju bëni, në raportin e vitit 2019 do të bëhet e mundur që edhe kjo të jetë pjesë e raportit.

Ju rikujtoj se duke pasur mungesë stafi, edhe puna me statistikën e mirëfillta lë për të dëshiruar, pasi kemi ngarkesë shumë të madhe, arsye për të cilën nuk mund të shkëpusim një staf për t'u marrë me këtë gjë në mënyrë të dedikuar. Megjithatë, me procesin e rekrutimit, besoj se do ta arrijmë edhe këtë.

Për sa i përket çështjeve që janë në gjykatë, për saktësim janë vetëm shtatë vendime të pranuar në gjykatë, dhe këto janë vetëm në shkallën e parë. Pra, ne i kemi ankimuar ato në apel, por vendimi nuk ka marrë formë të prerë.

Për së ai përket informacionit, atë do t'jua vëmë në dispozicion me shkrim, brenda ditës së sotme, sepse është diçka e mundur, në lidhje me të gjitha fushat për të cilat ju kërkonit të informoheni.

Arben Ahmetaj – Pyetje tjetër?

Po, ju lutem!

Evis Kushi – Po, faleminderit, kryetar!

Unë kam një pyetje që lidhet me ankimimet që bëhen në institucionin tuaj. Nuk e di nëse ju keni ndonjë statistikë për përqindjen e këtyre ankimimeve, sipas sektorëve të caktuar. Megjithatë, edhe nëse nuk e keni, unë e pashë me kujdes gjithë listën e ankimimeve, që ju keni paraqitur në raport, është e qartë se sektori i sigurisë fizike, pra i rojeve private, ka numrin më të madh, madje, në një raport shumë të theksuar, me një diferencë shumë të madhe me sektorët e tjerë. Kjo sjell shumë vonesa, sjell shumë problematika, madje sjell bllokim të procesit.

A keni menduar të propozoni një lloj tjetër procedure të prokurimit publik në lidhje me këtë sektor, në mënyrë që ky sektor të zhbllokohet? Për shembull, po jap një rast, thjesht një supozim: nëse është e mundur, që këtu të bëhet ofertomi sipas marzhit të fitimit dhe jo me vlerën totale, që do të thotë të fitojë ai që ka marzhin më të ulët të fitimit.

Kjo mund të ishte një mënyrë. A është e mundur apo jo?

Arben Ahmetaj – Propozojeni edhe me shkrim këtë ide, zonja Kushi, se është ide interesante!

Ndërkohë, ju lutem, kryetare!

Evis Kushi – Sepse, për sa i takon kostos, ato i kanë të gjitha kostot njësoj. Është me vendim të Këshillit të Ministrave. Kështu, ndoshta një mënyrë e re e procedurës së prokurimit publik mund ta zhbllokonte procesin, sepse është problem. Jo vetëm vitin e kaluar, por ndër vite.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ju lutem!

Evis Shurdha – Faleminderit!

Në lidhje me këtë çështje, e cila është, le të themi, gjysma e veprimtarisë së KPP-së, që do të thotë se prevalojnë rastet e shqyrtimit të ankesave sa i takon shërbimit të sigurisë fizike, nga viti në vit që kur ky shërbim nuk ka qenë më shtetëror.

Ka një iniciativë të qeverisë, me krijimin e një agjencie, institucioni, e një sh. a. – je, për ta ofruar sivjet këtë shërbim, në mënyrë shtetërore. VKM-ja ka dalë, por nga ana tjetër nuk është akoma në fuqi, që ta bënte të mundur këtë shërbim për të gjitha institucionet shtetërore. Besoj se në momentin kur ajo të bëhet operative, do ta ulë numrin e autoriteteve që do ta prokurojnë këtë shërbim nëpërmjet procedurave të prokurimit publik. Sh. a.- ja është në varësi të Ministrisë së Brendshme.

Nga ana tjetër, problematikat e kësaj fushe janë absurde, sepse, ashtu siç tha edhe zonja Kushi, të gjithë ofertojnë në kosto. Ajo që ne do të propozonim, që gjithsesi ju takon juve ta merrni në konsideratë, është: meqenëse të gjithë operatorët ofertojnë në të njëjtin çmim, të kishte një lloj procedure me faza, faza e parë e së cilës të ishte plotësimi i kapaciteteve teknike dhe financiare. Në momentin e dytë të kishte një shortim të të gjithë operatorëve që i plotësojnë këto kriteret. Kjo do të ishte më e drejtë, do të facilitonte gjithë procesin dhe nuk do të kishte ankimime pa fund, sepse procedura të tilla ku marrin pjesë njëzet operatorë, sipas legjislacionit, ato legjitimohen në faza të ndryshme për të ngritur ankesë. Pra, një procedurë mund të zgjasë edhe një vit.

Ky është propozimi ynë, por është rekomandim, pastaj si ta vlerësoni ju ose jo.

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Ka pyetje të tjera? Po, zonja Dhima.

(Deputetja Dhima flet pa mikrofon.)

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Në fakt, shqyrtimi i ankesave në Komisionin e Prokurimit Publik duhet të bëhet brenda 15 ditëve. Kjo, në fakt, nuk ndodh.

Me ndryshimet në strukturë, Kuvendi ka miratuar që në datën 19.07.2018 strukturën, e cila do të fillonte nga puna që më 1 janar të vitit 2019.

Sot nga 30 pozicione që keni në strukturë, keni të plotësuara vetëm 24, çka do të thotë se gjashtë pozicione i keni të paplotësuara. Ndaj, mendoj dhe gjykoj se duhet të ishin marrë masat nga ana juaj që këto pozicione të ishin plotësuar, sepse normalisht do të ndikonin në cilësinë e punës dhe në shqyrtimin në kohë të ankesave.

Arben Ahmetaj – Më falni, është pyetje, apo koment?

Antoneta Dhima – E kam pyetje.

Arben Ahmetaj – Atëherë, bëjeni pyetjen.

Antoneta Dhima – A mendoni se struktura që keni, dhe duke pasur këtë ngarkesë të ritmeve të ankesave që keni pranë Komisionit të Prokurimit Publik, do t'i përballoni dhe do të ktheni përgjigje në kohë brenda 15 ditëve të shqyrtimit të ankesave?

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Po, zonja Shurdha.

Evis Shurdha – Edhe këtu dua të bëj një parantezë. Pra, në tipologjinë e ankesave që Komisioni i Prokurimit Publik merr në shqyrtim, ka një kategorizim të çështjeve: ka çështje komplekse dhe të thjeshta, për të cilat KPP-ja ka mbajtur tashmë një qëndrim të mëparshëm.

Për pjesën e shqyrtimit të ankesave në afat, ligji na ka parashikuar një afat prej 15 ditësh, por, gjithsesi, për qëndrime jashtë afatit 15-ditor, vetë ligji na ka dhënë mundësinë e një 15-ditëshi tjetër, por me kusht që të njoftojmë autoritetet, personat e interesuar, të cilët kanë paraqitur ankesë ose preken nga kjo vendimmarrje e KPP-së për këtë shtyrje afati. Kjo do të thotë se afati maksimal i shqyrtimit në KPP është 30 ditë.

Aktualisht, meqenëse jemi në situatën e kushteve të jashtëzakonshme (që jemi në mungesë stafi, për të cilin dua të theksoj se kanë nisur procedurat e rekrutimit, pra ne jemi në proces, është vetëm përmbyllja e tyre për të gjitha vendet vakante), nëse do të ishte optimale ose jo kjo strukturë, duhet ta shohim një herë në *full force*, që të marrim konkluzionet nëse kjo strukturë na mjafton, por duhen parë edhe prurjet që do të na vijnë, sepse ju rikujtoj që janë pjesë e shërbimit civil. Pra, procedurat bëhen në raport me legjislacionin e shërbimit civil.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pra, duhet t'i plotësojmë këto vende që të shohim nëse na duhen të tjerë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem!

Arben Ahmetaj – Ka pyetje të tjera?

Po, zoti Sinaj.

Vullnet Sinaj – Faleminderit, zoti kryetar!

Kam dy pyetje.

E para ka të bëjë me numrin e ankesave, që kanë ardhur në Komisionin e Prokurimit Publik. Sipas raportit tuaj, kanë ardhur rreth 315 ankesa nga autoritete kontraktore për minierat, koncesionet, partneritetin publik-privat, si dhe 840 ankesa të tjera për prokurime, ankande, koncesione, që në total bëjnë rreth 1150 ankesa. Sa nga këto ankesa keni arritur t'i shqyrtoni brenda vitit?

Pyetja e dytë.

Në raportin tuaj thuhet se për të gjitha ankesat, që bëjnë ndërmarrjet ose subjekte të ndryshme private për prokurimet publike, ju u merrni një tarifë të caktuar dhe ua ktheni paratë mbrapsht të gjithë atyre që kanë të drejtë pas analizës që i bëni ankesës, ndërkohë të tjerëve ua mbani dhe i arkëtoni në buxhetin e shtetit. Kjo është më se normale, por unë shikoj dy shifra, pra ajo, që keni kthyer mbrapsht, është rreth 36 milionë e 52 622 lekë, ndërsa vlera e arkëtuar në buxhetin e shtetit është 69 milionë e 369 416 lekë. Kjo do të thotë se ka një raport një me tre, ku nga tri ankesa, njëra ka dalë e drejtë, ndërsa dy kanë dalë të padrejta në këtë shifër.

Po të ecim më tutje në raportin tuaj, vlera totale, që u përgjigjet ankesave që keni marrë në shqyrtim, është rreth 18 miliardë e 800 e ca milionë lekë. Një e treta është 6 miliardë lekë. Atëherë, institucioni juaj, pasi ka bërë këto konstatime dhe u ka dhënë të drejtën këtyre ankuesve, çfarë masash ka marrë për institucionet shtetërore ose për autoritetet kontraktore, që kanë bërë tenderime ose koncesionet?

Këto ishin pyetjet e mia.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Faleminderit, zoti Sinaj!

Cila është përgjigjja, zonja kryetare?

Evis Shurdha – Së pari, dua t’ju sqaroj që pranë Komisionit të Prokurimit Publik gjatë vitit 2018 janë depozituar 1158 ankesa. Duhet bërë një lexim ndryshe në raport, sepse ne kemi marrë në shqyrtim 1148 ankesa për vendime të marra gjatë vitit 2018. Cili është shpjegimi? 76 ankesa janë të mbartura nga viti 2017 (të depozituara gjatë muajit dhjetor), ndërkohë nga 89 ankesa, që kanë ardhur në vitin 2018, janë shqyrtuar gjatë vitit 2019. Pra, nga totali prej 1158 ankesave që janë depozituar në KPP gjatë vitit 2018, 1148 kanë qenë për procedura të prokurimit publik, dy koncesione, pesë ankande dhe tri leje minerare.

Për sa u përket tarifave...

Vullnet Sinaj – Sa janë shqyrtuar?

Evis Shurdha – Pikërisht nga 1158 ankesa të depozituara pranë KPP-së, 1145 janë shqyrtuar brenda afatit, plus...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Arben Ahmetaj – Cili ishte komenti juaj, zoti Sinaj?

(Deputeti Sinaj flet pa mikrofon.)

Vullnet Sinaj – Komenti im është që numri i ankesave, që është këtu dhe në qoftë se janë shqyrtuar... I bie që këta të kenë katër ankesa në ditë.

Arben Ahmetaj – Nuk është pak.

Vullnet Sinaj – Jo, shumë është.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – Nuk është pak. Kështu që ritmi ka qenë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po.

Evis Shurdha – Ju rikujtoj këtu që jo çdo...

(Deputeti Sinaj ndërhyrje pa mikrofon.)

Vullnet Sinaj – ...më bëri përshtypje që do të shtohet numri i punonjësve.

Arben Ahmetaj – Kjo tregon që nuk ka nevojë për shtimin e punonjësve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Evis Shurdha – Ju rikujtoj këtu që shumë ankesa grupohen në një vendim të vetëm. Pra, mund të kemi raste kur për dhjetë ankesa merret me një vendim, prandaj ka një diskordancë ndërmjet numrit të vendimeve dhe atij të ankesave, por ka edhe raste kur për një ankesë të vetme ka një vendim të veçantë.

Për sa i përket leximit që ju u bëni tarifave të kthyer në buxhet dhe atyre që u kthehen operatorëve, ju rikujtoj që tarifat nuk janë të njëjta për çdo procedurë të ankimit në Komisionin e Prokurimit Publik. Pra, nëse flasim për procedurën e prokurimit, ne kemi një tarifë prej 0,5% të fondit limit, ndërsa për sa i përket ankandit publik kemi një tarifë prej 0,5% të vlerës fillestare të ankandit.

Arben Ahmetaj – Ky nuk ishte thelbi i pyetjes.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Evis Shurdha – Jo, jo, sepse...

Arben Ahmetaj – Më falni! Thelbi i pyetjes ishte: çfarë mase merret? Derivohej vullneti nga tarifa të shumta dhe të personat përgjegjës mbrapa vendimmarrjeve, le të themi, në njësitë shpenzuese që kanë marrë vendime të gabuara. Kjo ishte logjika. Nuk ka rëndësi sa është tarifa.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Evis Shurdha – Për sa i përket pjesës ku KPP-ja sugjeron, meqenëse APP-ja është organi përgjegjës për kryerjen e një hetimi administrativ, kur zyrtarët përgjegjës janë shkelës apo keqmenaxhues të procedurave të prokurimit publik. Ne kemi referuar 4 raste në APP dhe i kemi kërkuar APP-së nisjen e hetimit administrativ, kur, sipas nesh, ka pasur indicie që nga ana e autoritetit kontraktor, jo nga persona të veçantë, se dokumentacioni që na përcillet nuk është

nominal, por është *on behalf* të institucionit, për të cilat APP-ja është në shqyrtim, kur ka pasur indicie që mund të ketë pasur shkelje të procedurave të prokurimit publik.

Nga ana tjetër, për sa i përket keqleximit të legjislacionit të prokurimit publik nga disa institucione, ju rikujtoj se për raste të ngjashme, ne tashmë e kemi krijuar jurisprudencën, që edhe autoritetet kontraktore, pra ato që e përdorin legjislacionin e prokurimit publik, të informohen dhe ta dinë paraprakisht se cili është qëndrimi i KPP-së si organi më i lartë në shqyrtimin e ankesave, për çështje të ngjashme, që do të thotë se KPP-ja ka përcaktuar disa shtylla të kësaj jurisprudence.

Arben Ahmetaj – Urdhëroni!

Vullnet Sinaj – Unë mendoj se është e drejta jonë si komision, që t’ia kërkojmë agjencisë se çfarë është bërë. Këta duhet ta dinë se çfarë është bërë me këto institucione apo me personat që i kanë bërë tenderët dhe... Ata duhet të na kthejnë një përgjigje, nëse janë marrë masa, se në të kundërt, vazhdohet me gabimet në të ardhmen.

Arben Ahmetaj – Një sekondë!

Ju keni shumë të drejtë në atë që parashtroni. Besoj se kombinimi mes KPP-së dhe APP-së, përgjegjësitë juridike, aq më shumë që KPP-ja funksionon gati si një gjykatë e prokurimeve, praktikisht përderisa merr vendime për procedurën, duhet të rekomandojë apo ndoshta duhet

përmirësuar edhe legjislacioni për të marrë vendime për ata që kanë shkelur procedurat, sepse ka një pyetje fare të thjeshtë, kryetare: Sa kanë ndryshuar qëndrimet, vendimet nga njësitë shpenzuese të KPP-ja dhe të Gjykatës Administrative? Po ju jap një shembull për t’ju lehtësuar përgjigjen: A mund të më tregoni ju, në 100 vendime që kanë marrë njësitë shpenzuese, sa ankesa janë bërë në përqindje? Ju thatë se keni vlerësuar 1145 ankesa në vitin 2018. Në qoftë se keni vlerësuar 1145 ankesa, sa nga këto janë rrëzuar nga ju dhe sa nga këto kanë qëndruar? Sa nga vendimet tuaja kanë qëndruar në gjykatë dhe sa janë rrëzuar? Për të marrë një vlerësim, sepse të rekomandosh vetëm 4 masa, ndërkohë që kjo çështje në progresraport është kapur më vete, unë besoj se kjo ka nevojë për më shumë fokus. Çështja që ngre Vullneti, është shumë e saktë. Kështu që, do t’ju lutem ta detajoni më tej!

Evis Shurdha - Nga 1145 ankesa në total, 602 nuk janë pranuar, pra në 602 kërkesa të marra në shqyrtim nga KPP-ja institucionet kanë vepruar drejt në raport me KPP-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga 1145 ankesa në total, 602 ankesa nuk janë pranuar, pra kjo do të thotë se ne si KPP, nuk e kemi pranuar kërkesën e operatorit. Autoriteti ka qenë i saktë në lidhje KPP-në.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në përqindje 52,58%.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, 38,86% janë pranuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rreth 39%.

Arben Ahmetaj – Pse?

Evis Shurdha – Sepse ka edhe arsye të tjera që janë procedurale, si për shembull, nuk janë në afat, në rastet kur ka mosplotësim të kushteve formale nga ana e operatorëve, që do të thotë se nuk ka lidhje me qëndrimin...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo me themelin, por me procedurën.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Arben Ahmetaj – ... Kjo do të thotë se gjysma e vendimeve të njësive shpenzuese, nuk janë në përputhje me legjislacionin dhe me procedurën. Apo nuk është kështu? Nuk e di nëse e thashë saktë.

Evis Shurdha – Atëherë, më duhet të sqaroj edhe një element tjetër, që e thashë pak më parë. Jo të gjitha ankesat janë dhe i korrespondojnë një procedure të vetme, që do të thotë, se ka raste kur ankesat grupohen dhe bëhet fjalë për 5 ankesa që janë për një procedurë. Kjo do të thotë se ky indikator nuk është i lexueshëm plotësisht.

Arben Ahmetaj – Dakord. Për të lehtësuar kuptueshmërinë e pyetjes sime, po ju bëj një pyetje tjetër: Nga 1145 ankesa, sa janë procedurat që ju keni pranuar që janë të gabuara?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mirë.

Atëherë, nëse ligji ju detyron që ta jepni mbi ankesat, mos u transfero te procedurat, por rri te ankesat dhe, nga 1145 ankesa në total, 602 ankesa nuk janë pranuar.

Evis Shurdha – Po, janë mospranuar. Kjo do të thotë që ka pasur të drejtë autoriteti.

Arben Ahmetaj – E qartë.

Kjo do të thotë se në 1145 raste të ankuara, njësitet shpenzuese kanë pasur të drejtë në bazë të ligjit, në 602 raste.

Pavarësisht grupimit, ligji e kërkon me ankesa. Kjo do të thotë (nëse i referohemi) 39% të rasteve janë rrëzuar nga ju (dhe unë nuk kam vajtur akoma nga ju te gjykata), ju sot nuk jeni në gjendje të më thoni se sa procedura janë këto 39%.

Evis Shurdha – Brenda një jave mund t'jua vë në dispozicion.

Arben Ahmetaj – Ju keni kërkuar vetëm 4 procedime administrative nga APP-ja. Domethënë në 39% të rasteve, ju keni gjykuar ndryshe nga njësitë shpenzuese. Ju jeni në referencë të ligjit. Mund t’ju quaj si gjykata e prokurimeve dhe keni dhënë 39% për çështjet.

Kam një pyetje para se të nxjerr konkluzionin tim: Në 100% të rasteve, sa punonjës të administratës qendrore dhe vendore janë përfshirë?

Pra, nëse ju keni 1145 ankesa, sa është numri i komisionerëve të përfshirë të njësive shpenzuese?

Evis Shurdha – Ka disa hallka. Kemi njësinë e prokurimit, komisionin e vlerësimit të ofertave dhe komisionin e shqyrtimit të ankesave, që do të thotë se ka institucione që i kanë hallkat të përhershme dhe ka institucione që i kanë *ad hoc*.

Arben Ahmetaj – A e di pse po ta bëj këtë pyetje? Nëse KPP-ja ka rrëzuar 39% të 1145 ankesave, i bie afërsisht që për rreth 450 çështje, ka vendosur ndryshe, ti ke vendosur ndryshe, jo ti si person, por komisioni ka vendosur ndryshe nga njësitë shpenzuese. Në qoftë se në 450 çështje përfshihen minimalisht 5 veta, janë gati 2250-2300 punonjës, një herë ose disa herë të përfshirë. Në 2300 punonjës, që kanë shkelur ligjin, KPP-ja ka rekomanduar vetëm 4. Domethënë, kjo lë shumë për të dëshiruar që në të ardhmen të krijohet edhe një procedurë shumë e saktë, në mënyrë që kur të merren vendime për çështjet, të merren vendime, jo rekomandime për administratën publike. Kjo është e rëndësishme dhe këtë element do ta përfshijmë edhe në rezolutë.

Pyetje tjetër ka?

Po, zonja Blerina.

Blerina Gjylameti- Në çështjet e opinionit, pavarësisht numrit të ulët të punonjësve, marrjes së shumë vendimeve brenda afateve dhe faktit të eficiencës së institucionit apo transparencës, që janë për t’u vlerësuar për punën që bën institucioni, të cilin ju drejtoni, unë vazhdoj të këmbëngul te fakti që do të duhet të kemi, në respekt edhe të rekomandimeve të lëna qoftë nga KLSH-ja, por edhe në respekt të rezolutës së Kuvendit dhe faktit që ju raportoni në këtë komision, informacion më të detajuar dhe evidenca më të plota në lidhje me pyetjet që unë dhe të gjithë ne si komision ngritëm. Më pas, edhe në përmbushje të rekomandimeve që janë rezolutë, të cilat duhen plotësuar, duhet të rritim jo vetëm besueshmërinë e publikut për paratë nga taksapaguesit për eficiencën e shpenzimeve të tyre, por edhe propozimet që ju duhet të bëni, në mbështetje edhe të asaj që tha kryetari, për procedurat e prokurimit publik, në mënyrë që të mos kemi rritje të numrit të ankesave te ju, por të kemi përmirësim të procedurave, që të zgjidhen që në shkallën e parë, pra te pjesa e APP-së apo të gjitha institucioneve që merren me pjesën e prokurimit publik.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Para se ta mbyllim takimin dhe të kalojmë në votimin e dy rezolutave, unë dua të bëj dy komente, të cilat kanë të bëjnë me vazhdimësinë e punës tuaj. Ajo që është e rëndësishme është që ju duhet të keni një platformë transparence me publikun, për vendimmarrje specifike ose për vendimmarrje në tërësi.

Së pari, dua t’ju sugjeroj që të bëni takime me medien në vazhdimësi për t’i informuar për vendimmarrjet dhe për të mos lënë zona gri në informacion.

Së dyti, besoj se keni nevojë që të hyni në një proces të menjëhershëm për përmirësimin e procedurave dhe legjislacionit, aty ku, në bazë të eksperiencës suaj, ju mendojnë se ka zona gri dhe aty ku verifikohen, qoftë nga njësitë shpenzuese, por edhe nga ju, si një lloj gjykate.

Së treti, si komision, besoj se duhet të kopjoni një praktikë të ligjit “Për administrimin fiskal”, i cili ka të bëjë me precedentët. Pra, ashtu siç referuat në fjalën tuaj ka çështje që janë të ngjashme për shkelje të ngjashme. Besoj se duhet të prodhoni një manual precedentësh, në mënyrë që njësitë shpenzuese ta kenë parasysh fare qartë, që në rastin X në vitin 2018 një procedurë e trajtuar njëlloj është rrëzuar. Domethënë, në qoftë se njësitë shpenzuese bënë të njëjtin gabim, do të ketë të njëjtin rezultat, sepse i njëjti gabim nuk mund të ketë dy rezultate. Besoj se manuali i precedentëve do të ishte shumë i rëndësishëm edhe për transparencë.

Në rezolutë ne kemi lënë një sërë detyrash, nuk do të presim vitin tjetër për t’u ulur sërish. Besoj se në fillim të shtatorit do të ulemi përsëri së bashku që të keni një raportim për ecurinë e rezolutës dhe për ato problematika, që sot i ngritëm së bashku.

Së fundi, dua t’ju sugjeroj t’u bëni një letër informuese për raportin tuaj të gjitha njësive shpenzuese, për vendimmarrjen, për problematikat dhe për çfarë duhet të kenë parasysh ata. Besoj se do të rriste komunikimin, informacionin dhe transparencën me njësitë shpenzuese.

Faleminderit dhe punë të mbarë!

Nuk ka nevojë të rrini. Unë do të vazhdoj me votimin e dy rezolutave. Rezoluta për INSTAT-in

Kush është dakord me rezolutën për INSTAT-in? Kundër? Abstenim? Miratohet.

Rezoluta për KPK-në

Kush është dakord? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Këtu e mbyll komisionin dhe të dyja rezolutat e aprovuara nga ju ia kaloj seancës për votim!

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA

Sekretar
Anastas Angjeli

Përgjegjësja e Sektorit të Redaktorëve
Euzheni Pengili

Sekretar i komisionit
Elvi Prifti